



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.03.2014, ora 10:00-11:20

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Ridvan Bode, Anastas Angjeli, Andrea Marto, Arben Çuko, Majlinda Bufi, Ervin Koçi, Evis Kushi, Dashamir Shehi, Florion Mima, Blerina Gjylameti, Sherefedin Shehu, Ilir Xhakolli, Igli Cara, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu dhe Liljana Elmazi.

Mungojnë:

Agron Çela, Koço Kokëdhima, Luan Duzha, Albana Vokshi, Përparim Spahiu, Jorida Tabaku, Gjovalin Kadeli dhe Edmond Spaho.

Të ftuar:

Bujar Leskaj – kryetar i KLSH-së

Luljeta Nano – sekretare e Përgjithshme në KLSH

Ermal Yzeiri – drejtor juridik në KLSH

HAPET MBLEDHJA

Miratimi i procesverbalit.

Erion Braçe – Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar”. Pjesë e punës – natyrisht prezantimi i projektligjit, por edhe e diskutimit që do të bëjmë mbi të, deri në miratimin e tij prej Komisionit – do të jetë kryetari i KLSH-së, zoti Bujar Leskaj.

Do të doja t’ju bëj më dije se ky projektligj kërkon një shumicë të cilësuar të votave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, parashikuar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që njëherësh shprehet qartësisht për pavarësinë institucionale dhe forcimin e saj. Për këtë arsye, do të doja që puna në këtë komision të ishte sa më teknike e profesionale, me qëllim që të arrijmë pikat e përbashkëta, për ta çuar në fund me konsensus këtë projektligj në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Doja të theksoja që qëllimet kryesore të këtij projektligji kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përafrimin e mëtejshëm të dispozitave në këtë projektligj me ato që konsiderohen detyrime që vijnë nga praktikat më të mira të vendeve të BE-së, natyrisht të forcimit edhe më tej të pavarësisë institucionale dhe financiare të KLSH-së, qartësimin dhe saktësimin e të drejtave dhe detyrave, si dhe kompetencave të KLSH-së gjatë ushtrimit të detyrës kushtetuese në veprimtarinë e parashikuar në ligj, natyrisht të drejtat dhe detyrat e subjekteve të audituara në akord me procedurën e auditimit dhe mbi të gjitha dhënien e një statusi për nëpunësit e KLSH-së, gjithmonë, në fokus, për të rritur përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e tyre institucionale gjatë ushtrimit të detyrës së parashikuar nga ligji.

Ia kaloj fjalën zotit Leskaj, për të prezantuar projektligjin dhe pastaj secili nga deputetët është i lutur të adresojë pyetje dhe më tej vijnë diskutimet lidhur me gjithçka që parashikon projektligji për diskutim.

Bujar Leskaj – Qysh në fillim të prezantimit të këtij projektligji të përgatitur nga KLSH-ja, më lejoni, të nderuar deputetë, të shpreh falënderimin për dashamirësinë dhe mirësinë që keni treguar ndaj këtij ligji, i cili më së fundit futet në agjendën e Kuvendit. KLSH-ja, në vijim të përpjekjeve për të përputhur veprimtarinë e vet me standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe me legjislacionin bashkëkohor të

institucioneve homologe dhe të zhvilluara, si dhe në zbatim të kërkesave e rekomandimeve të progresraporteve të fundit të Komisionit European ka përgatitur amendimet e ligjit të tij organik nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar, me ndihmën teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të DG Budget të buxhetit të Komisionit European dhe të projektit SIGMA të BE-së dhe të OSBE-së. Nga ana tjetër, brenda vendit, ky proces është konsultuar me institucione të ndryshme shtetërore, me përfaqësues të shoqërisë civile. Në rrugë informale është diskutuar dhe me deputetë të Komisionit të Ekonomisë, me grupe të ndryshme interesi, duke përfshirë në veçanti qarqet akademike të fushës juridike dhe ekonomike.

Përfitoj nga ky rast që nga ky Komision i nderuar të falënderoj të gjithë ata përfaqësues, vendas dhe të huaj, që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij projektligji. Do të lejoni që në fillim të fjalës sime të citoj një vlerësim nga drejtori i Përgjithshëm i DG Budget, me 18 tetor 2012. Pasi siguron për mbështetjen maksimale teknike të Komisionit European për amendimet e ligjit të KLSH-së, shprehet se: “Amendimet e sjellin institucionin e KLSH-së tërësisht në linjë me standardet INTOSAI”. Kujtoj këtu se këto amendime janë sjellë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me 29 nëntor 2012 dhe janë risjellë në legjislaturën e re. Zoti Robert Jelist, drejtor njësie në DG Budget, i cili ka ardhur personalisht dy herë për ligjin e ri të KLSH-së, në tetor të vitit 2012, ku mori pjesë në tryezat e punës të organizuara me këtë rast, si dhe në dhjetor të vitit 2013, kur u takua me Kryetarin e Parlamentit, zotin Ilir Meta, gjatë konsultimeve me palët e interesit në nëntor të vitit 2013 ka cilësuar se: “Projektligji i ri jep një strukturë të qartë dhe terminologji të standardeve ndërkombëtare. Ai ka referenca të qarta për auditimet e performancës dhe përkufizim më të fortë të rolit dhe të të drejtave të KLSH-së”.

Amendimet e ligjit të KLSH-së janë një përparim i madh. Ato e sjellin auditimin e jashtëm publik në Shqipëri në një linjë me standardet ndërkombëtare. Domosdoshmëria e kryerjes së ndryshimeve në ligjin organik të mëparshëm të KLSH-së ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, ku më kryesorët, më lejoni të citoj, kërkesat dhe angazhimet e Shqipërisë të përcaktuara në MSA. Sipas nenit 90 të MSA-së, bashkëpunimi mes palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me të drejtën e komunitetit, në fushën financiare, në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik e të auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një

sistem efikas të kontrollit financiar të brendshëm publik dhe sistemet e auditimit të jashtëm në Shqipëri në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranura botërisht, si dhe me praktikat më të mira të BE-së. Bazuar në këto përcaktime të MSA-së dhe në këto kërkesa të saj, progresraportet e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013 të Komisionit European për Shqipërinë kanë theksuar vazhdimisht kërkesat për kryerjen e llojeve të reja të auditimit, auditim performance dhe certifikimi, për forcimin e kapaciteteve të performancës së KLSH-së, për ndjekjen sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe së fundi miratimin e projektligjit të ri “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Më konkretisht, po citoj pjesë të shkëputura në progresraportin e vitit 2011 për Shqipërinë. Komisioni European shprehet se: “Progres i limituar është bërë në llojet e reja të auditimit, të tilla si certifikimi dhe auditimi i performancës”. Amendimet në ligjin për institucionin suprem shtetëror të auditimit SAI, për ta sjellë atë plotësisht në linjë me standardet e tij NOSAI, janë duke u përgatitur. Amendimet duhet të adoptohen në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në linjë me standardet INTOSAI. Ka akoma pak progres në fushat që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Në progresraportin e vitit 2012 për Shqipërinë, Komisioni European, ndër të tjera, shprehet: “Pas vitesh nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të forcuar kapacitetet e performancës e KLSH-së”. Pas disa vitesh në pezullim janë përgatitur dhe janë dërguar për miratim ndryshimet e ligjit të SAI-t për ta sjellë në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t. Në progresraportin e vitit 2013 për Shqipërinë, Komisioni European shprehet: “Ndryshimet në ligjin e KLSH-së janë në pritje dhe nevojitet përfshirja e një performance të qëndrueshme auditimi”. Janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedura të reja për të rritur efencën e KLSH-së. Megjithatë, ndryshimet në ligjin për KLSH-së janë duke u shqyrtuar në parlament që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me shumicë 3/5. Aktualisht, nuk ka ndjekje sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së.

Në standardet ndërkombëtare INTOSAI, dy prej tyre konsiderohen si më kryesoret: ISSAI 1, Deklarata e Limës, e quajtur ndryshe Kushtetuta e Komuniteteve Supreme të Auditimit dhe ISSAI 10, Deklarata e Meksikës, e cila flet për pavarësinë e SAI-ve. Projektligji i ri mbështetet plotësisht në këto standarde si dhe në standarde të tjera ndërkombëtare si ato të IFAC-ut dhe në rezolutat e kongreseve INTOSAI-t dhe

EUROSAIT-it. Në këtë këndvështrim, miratimi i një ligji të ri për KLSH-në është i domosdoshëm në funksion të përjasjes së plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, gjë që ka ndodhur me shumicën e legjislacioneve institucioneve homologe të auditimit.

Së dyti, përshtatja e legjislacionit të KLSH-së si institucion i auditimit të jashtëm me ndryshimet e bëra në legjislacionin për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007. “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” në përmbajtjen dhe terminologjinë juridike mbetet një ligj bashkëkohor në krahasim me ligjin organik ekzistues të KLSH-së. Miratimi i një projektligji të ri për KLSH-në, në vazhdim të punës së bërë për ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si dhe asimilimin në ligj të standardeve ndërkombëtare të auditimit plotëson në tërësi kuadrin e nevojshëm ligjor për sa i përket auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

Së treti, zëvendësimi i terminologjisë së vjetër juridike të ligjit ekzistues me terminologjinë bashkëkohore. Ligji organik i KLSH-së nr. 8270, datë 23.12.1997, vazhdon të mishërojë terminologji të vjetër juridike dhe financiare të një periudhe kur ky institucion konsiderohej si një institucion i kontroll-revizionit të pasqyrave financiare. Kjo terminologji aktualisht nuk përdoret më në legjislacionet e institucioneve homologe. Madje, as në legjislacionin tonë mbi auditin e brendshëm në sektorin publik. Kështu, për shembull, termi “kontroll” nuk i përshtatet kërkesave të standardeve ndërkombëtare dhe nuk përputhet plotësisht me konceptin dhe përmbajtjen e termit “auditim”, i cili ka fituar qytetari edhe në vendin tonë.

Risitë e projektligjit të paraqitur:

1. Zgjerimi i objektit të veprimtarisë audituese

Në projektligjin e ri janë përcaktuar dhe përkufizuar, krahas auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare edhe kryerja e auditimit të performancës, auditimit të IT-së dhe certifikimit të llogarive financiare. Përcaktimi në ligj i të gjitha llojeve të auditimit është i domosdoshëm dhe e vendos KLSH-në në një nivele zhvillimi dhe performance me institucione moderne. Më lejoni të citoj këtu një personalitet të INTOSAI-t, dr. Mosef, president i Gjykatës së Auditimit të Austrisë: “Auditimi dhe këshillimi janë dy fytyra të së njëjtës monedhë”. Nga njëra anë, problemet dhe mundësitë për përmirësim janë analizuar dhe identifikuar gjatë retrospektivës, pra aditiveve të

bazuara në fakte dhe, nga ana tjetër, ato plotësojnë me qasjen e këshillimit largpamës me rekomandime për të përmirësuar dhe rritur ekonominë, si dhe efikasitetin e qeverisjes publike. Ligji i ri jep këtë mandat të zgjeruar auditimi, duke futur konceptin dhe veprimin e auditimit të performancës. Një risi është që auditimi në KLSH, në mbrojtje të kërkesave financiare të BE-së dhe zbatim të MSA-së duhet të zhvillojë ndaj përdoruesve të fondeve të ofruara nga BE ose organizata të tjera ndërkombëtare. BE-ja, gjatë periudhës 2014-2020, ka vendosur rregulla të forta të kontrollit financiar. Ato bazohen në direktivat e Komisionit European për sistemet e kontrollit efektiv dhe auditimit të fondeve të BE-së si një nga çështjet kyçe. Administratat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal kanë më shumë përgjegjësi për të ndërtuar një sistem efektiv të kontrollit. Politika e kohezionit, e zbatuar kohët e fundit nga BE, u kërkon organizmave kombëtarë të vendeve përfituese të fondeve të BE-së një rol më të madh në monitorimin dhe kontrollin financiar të projekteve. Zgjerimi i mandatit auditues të KLSH-së nëpërmjet përfshirjes në ligjin e ri të së drejtës për të audituar fondet e BE-së, përkon me praktikën e mira në menaxhimin, kontrollin financiar dhe procedurat e fondeve strukturore të shteteve të ndryshme të BE-së. Ai përfshin menaxhimin e buxhetit të fondit, raportimin si dhe kërkesat e kontrollit financiar dhe të auditimit.

2. Auditimi dhe certifikimi i pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhëna e opinionit për to

Kjo ka qenë edhe një kërkesë e vetë ligjit organik, të neneve 62 dhe 63, të buxhetit. Në projektligjin e ri ato trajtohen respektivisht në nenet 9 dhe 10. Në nenin 9 parashikohet kompetenca e KLSH-së për auditimin e llogarive vjetore të institucioneve. Konkretisht: KLSH-ja ka kompetencë të auditojë zbatimin e buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nga personat e tjerë juridikë, duke përfshirë llogaritë vjetore. KLSH-ja çdo vit jep opinionin për raportin e konsoliduar vjetor të zbatimit të buxhetit, i cili përfshin dhe vlerësimin e bërë bazuar në nenin 15, paragrafi 1. Terminologjia është përshtatur me atë të përdorur në ligjin organik të buxhetit. Paragrafi i fundit i këtij neni është shtuar me sugjerimin e SIGMA-s, në mënyrë që të harmonizohet me ligjin organik të buxhetit, nenet 62 dhe 63. Referuar nenit 62 të ligjit organik të buxhetit të shtetit përcaktohet që: një kopje e raportit vjetor të konsoliduar të buxhetit të

shtetit, të cilin ministri i Financave e paraqet brenda muajit maj në Këshillin e Ministrave i dërgohet edhe KLSH-së, që auditon llogaritë vjetore të buxhetit.

Gjithashtu, në nenin 10 të projektligjit të ri përcaktohet qëllimi i kryerjes së këtij lloj auditimi, sipas të cilit nga auditimet financiare KLSH-ja duhet të përcaktojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar. Vendorsja e këtyre përcaktimeve garanton kryerjen e auditive financiare, pra dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Në standardin ndërkombëtar të auditimit SAI, ISSAI 2/200, standarde të IFAC-ut, objektivi dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare, paragrafi i tretë, përcaktohet se qëllimi i një auditimi është rritja e shkallës së besimit për përdoruesit e caktuar të pasqyrave financiare. Kredibiliteti i pasqyrave financiare të përgatitura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme do të rritet nëse opinionet e auditimit janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare.

Deklarata e Limës gjithashtu përcakton se koncepti i realizimit të auditimit është i qenësishëm në administrimin publik financiar, pasi menaxhimi i fondeve publike nënkupton besim. Këto i kemi parashikuar edhe në planin strategjik të zhvillimit institucional nën objektivin 2/2 “Zhvillimi i kompetencave të auditimit financiar dhe të kapaciteteve, për plan 2013-2017. KLSH-ja duhet të përgatisë veten për lëshimin e një opinionit mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar dhe dhënien e opinionëve mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara. Kjo nënkupton një rishikim të një manuali të auditimit financiar, duke përfshirë edhe udhëzime mbi opinione të auditimit dhe të raportimit. KLSH do të angazhohet në ndërtimin kapaciteteve audituese për kryerjen e këtij auditimi.

Jeni në dijeni, që ne kemi fituar nga fondet e projektit IPA 2013. Në këtë aspekt kemi parashikuar një kuadër të plotë skemash operationale, të cilat synojnë zhvillimin e metodologjive apo të kuadrit rregullator, manuale, udhëzime etj., për implementimin e mendimeve ligjore për sa i përket kryerjes së certifikimit të llogarive vjetore.

3. Përmirësimi i marrëdhënieve me subjektet e audituara

Projektligji i ri fuqizon të drejtën e KLSH-së për sigurimin prej subjekteve të audituara të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit shkresor dhe elektronik që ajo i

konsideron të nevojshme për realizimin e detyrave audituese. Parashikohet që këto subjekte jo vetëm që do të sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda një afati, qoftë edhe kur ai përbën një sekret shtetëror apo konsiderohet si konfidencial, por këto subjekte duhet që brenda një afati të caktuar kohor të raportojnë edhe në lidhje me marrjen e masave dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH-ja pas përfundimit të auditimit. Neni 25 synon të ezaurojë të gjithë problematikën e deritashme në lidhje me mosdhënien e informacionit apo dokumentacionit nga subjektet apo pengimi i detyrës. Sipas komenteve të SIGMA-s mundësia për të shfrytëzuar të gjithë bartësit e informacioneve dhe autoriteti i KLSH-së për të vendosur vetë për çka i nevojitet, është një përmirësim i rëndësishëm krahasuar me ligjin në fuqi, ku jepet një përshkrim i ngushtë i asaj çka KLSH-ja mund të kërkojë. Për këtë shprehet qartë edhe Parimi 4 i Deklaratës së Meksikos, ku thuhet se: “SAI duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të marrë në kohë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe informacionet për ushtrimin e përgjegjësisë. Gjithashtu, në projektligj shprehet qartazi një qasje akoma dhe më miqësore kundrejt subjekteve të audituara, si në lidhje me të drejtën e këtyre subjekteve për t’u njohur me planin e auditimit, ashtu edhe me të drejtën për t’u informuar dhe dhënë shpjegimet në lidhje me gjetjet e pasqyruara në procesverbalet dhe projektraportet e auditimit, të cilat bazuar në projektligjin e ri, janë të detyrueshme për t’u evidentuar në raportin përfundimtar.

4. Transparenca e rritur e veprimtarisë së KLSH-së ndaj publikut

Është parashikuar një dispozitë e veçantë në lidhje me informimin e publikut, neni 32, e dalë kjo nga tryezat me organizatat e shoqërisë civile, sipas të cilës KLSH-ja siguron natyrën publike të veprimtarisë së vet nëpërmjet raporteve të paraqitura në Kuvend, publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike, zhvillimit të konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media, sigurisht në respekt me dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me sekretin shtetëror, tregtar apo konfidencial. Ligji i ri siguron transparencë të plotë të institucionit me publikun, në bazë të direktivave të drejtimit të katërt strategjik të EUROSAT për vitet 2011-2017, i cili është qeverisja dhe komunikimi. Nga ana tjetër, sjell në vëmendjen tuaj që Deklarata e Pekinit në Kongresin XXI të INTOSAI-t, ka theksuar se: “SAI ndihmoi në ndërtimin e komunikimit dhe

besimit midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bëjnë të mundur që qytetarët të marrin pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

5. Certifikimi i audituesve të KLSH-së

Projektligji realizon përcaktimin e qartë dhe të plotë të statusit të nëpunësve të KLSH-së, duke parashikuar një sërë dispozitash ku evidentohen të drejtat, detyrimet dhe kushtet që duhet të plotësojnë punonjësit e KLSH-së, sidomos ata me detyra audituese. Më lejoni të citoj përsëri Robert Jelis, drejtor njësie në DG Budget, cili thekson se: “Certifikimi i audituesit është dëshmi e kompetencës mbi standardet e auditimit dhe lejon komunikim të standardizuar profesional”. Gjithmonë, kjo është në vlerësim të projektligjit tonë. Në dispozitat e fundit të këtij projektligji është parashikuar procedura ligjore për marrjen e statusit si auditues i jashtëm publik i certifikuar, status ky që do të siguronte një qëndrueshmëri dhe siguri të stafit të KLSH-së në ushtrimin e detyrës dhe kompetencave të tij ligjore.

6. Pavarësia financiare e KLSH -së

Autonomia financiare është një element kyç dhe i domosdoshëm i institucioneve supreme të auditimit publik, ISA-ve. Ajo u garanton ISA-ve pavarësinë e funksionimit normal ligjor, duke u dhënë mundësinë për të realizuar detyrat e tij kushtetuese dhe ligjore, bazuar në deklaratën e LIM-ës, neni 7 i saj, si dhe në deklaratën e Meksikos të vitit 2007, që i përkushtohet tërësisht pavarësisë së institucioneve supreme të auditimit.

Sigurimi i pavarësisë financiare dhe vepruese është ndër objektivat kryesore të përfshira në drejtimin e parë strategjik të strategjisë EUROSAI 2011-2016 për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe në drejtimin e katërt të strategjisë INTO/SAI 2011-2016 për një SAI të fortë dhe model.

Neni 5 i projektligjit të ri për KLSH-në e forcon pavarësinë financiare të institucionit, në vijim të ligjit të mëparshëm, pasi kjo pavarësi, në një farë forme, ka ekzistuar deri më sot. Mjetet financiare të KLSH-së përballohen nga buxheti i shtetit, me një kapitull të veçantë. Në ligjin e ri parashikojmë që KLSH-ja të propozojë çdo vit projektbuxhetin e saj në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, i cili e paraqet për miratim në Kuvend. KLSH-ja zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e saj të aprovuar nga Kuvendi. KLSH-ja përgatit çdo vit llogaritë e saj financiare në përputhje me legjislacionin për buxhetin. Llogaritë auditohen nëpërmjet një komisioni të posaçëm dhe

të pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe që raporton te ky i fundit ose te Komisioni i Ekonomisë.

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur risitë e këtij projektligj.

Të nderuar deputetë,

Për të qenë të ndërgjegjshëm dhe koherentë me profilin që duam të ndërtojmë si institucion suprem auditimi (ISA-i), kemi lënë edhe disa çështje për të cilat ne mendojmë se është, natyrisht, e drejta juaj, pa dyshim, për t'i vënë pikat mbi I. Më konkretisht, si “mangësi” të këtij projektligji mund të përmendim: mospërfshirjen sa duhet dhe në një mënyrë shumë eksplicite të rritjes së nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së, detyrimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe vendore për këtë gjë, pavarësisht se ne tani kemi një nivel të zbatimit të rekomandimeve tona në masën 75%. Më duhet t'ju rikujtoj se për masën disiplinore “Largim nga detyra” për drejtuesit e lartë asnjëherë nuk kemi shkuar mbi 50%.

Trajtimin e veçantë të së drejtës që ka KLSH-ja në drejtim të auditimit të koncesioneve. Ne do t'ju sjellim edhe praktikrat më të mira të institucioneve homologe të rajonit apo edhe më gjerë. Ne e kryejmë auditimin e koncesioneve, por nuk vazhdimësi në auditimin e tyre).

Trajtimin e të drejtës që KLSH-ja ka në administrimin e të ardhurave dytësore, që institucioni mund të krijojë nga bashkëpunimi dhe angazhimi në auditime të ndryshme, nga botime të ndryshe etj.

Përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve të KLSH-së si garanci e pavarësisë së tyre audituese.

Trajtimin juridik të statusit të kryetarit të KLSH-së në bazë të mbarimit të mandatit, si dhe rastet e mbarimit të këtij mandati, duke pasur parasysh se pavarësisht sugjerimeve të SIGMA-s dhe të BE-së, që kërkojnë një përcaktim të fortë dhe strikt se kur përfundon mandati.

Kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe jemi përpjekur në projektligjin tonë t'i referohemi dhe ta respektojmë këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Edhe një herë, unë ju falënderoj jo thjesht për vëmendjen që treguat gjatë prezantimit të këtij projektligji, por edhe për dëshirën dhe vullnetin e mirë politik, qytetar që po tregoni si ligjvënës dhe keni treguar në vijimësi ndaj KLSH-së.

Ju faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Leskaj, faleminderit për prezantimin tuaj të të gjitha aspekteve të projektligjit që do të marrim në shqyrtim!

Do të doja që për 5 çështjet e fundit, për të cilat ju folët dhe mendoni se duhen përfshirë te ndryshimet, në formulimet e këtij projektligji dhe për të cilat ky komision do të diskutojë, të adresohen formulimet respektive në komision, me qëllim që ne t'i marrim në shqyrtim në proces ata kapituj më të cilët është strukturuar projektligji.

Kalojmë në pyetje për projektligjin adresuar kryetarit të KLSH-së, në qoftë se deputetët kanë.

Urdhëroni, zoti Leskaj!

Bujar Leskaj – Për të qenë korrekt edhe me veten, edhe me kolegët e mi, unë këtu jam bashkë me sekretaren e Përgjithshme të institucionit, zonjën Luljeta Nano. Ajo duhet të ketë mbi 20-25 vjet në institucion. Ndodhet edhe drejtori i Drejtorisë Juridike, zoti Ermal Yzeiraj.

Erion Braçe – Edhe një herë, faleminderit!

Pra, kalojmë në pyetje për ato aspekte të projektligjit që janë edhe të reja, por që sjellin edhe riformulime të tjera në ligjin ekzistues të KLSH-së, për të cilat foli zoti Leskaj, por i keni të materializuara në relacion dhe në nenet e projektligjit. Në qoftë se do të duhet të kërkojmë sqarime nen për nen, mund t'i bëjmë edhe nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shehu, materiali ka ardhur që para një muaji në *mail*-in e të gjithë deputetëve. Më vjen keq, se jeni vetëm ju që e ngrini këtë shqetësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është faji im që vini pa materiale në mbledhjen e komisionit. Unë e kam fajin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shehu, edhe një herë sekretaret dhe zyrat jua ka hequr ish-Kryetarja e Kuvendit me një vendim të Kuvendit, për të cilin keni votuar vetë dhe e keni zgjidhur këtë problem që atëherë. Unë, për hir të së vërtetës, kam qenë kundër atij vendimi. Ju menduat se ai vendim do të ishte pozitiv. Urdhëroni!

Edhe një herë, për publikun, jo për ju, sepse e di që e bëni këtë gjë për sport, dua të sqaroj.

Sherefedin Shehu – Jo, nuk e bëj për sport. Për sport e bën ti, se po të ishte ashtu, e kishe miratuar para dy vjetësh këtë ligj. Sa kohë ka ligji që është përgatitur?

Erion Braçe – Zoti Shehu, nuk është faji im që ju nuk kishit maxhorancë në atë periudhë dhe nuk është faji im që ju nuk kishit dëshirë ta bënit atë punë.

Sherefedin Shehu – Nuk ke pasur ti dëshirë.

Erion Braçe – Unë e kam dëshirën. E kam sjellë këtu brenda; në Kuvend e ke për diskutim.

Sherefedin Shehu – E ke, por nuk ka ardhur me postë.

Erion Braçe – Edhe një herë: materialet kanë mbi një muaj që janë depozituar në *mail*-et e gjithsecilit prej deputetëve, relacioni bashkë me formulimet e të gjitha neneve, ashtu siç është bërë dy javë më parë lajmërimi për mbledhjen e sotme. Në qoftë se ka ndonjë çështje tjetër lidhur me projektligjin, urdhëroni të diskutojmë për përmbajtjen, por për anën formale është e kotë t'i hyjmë kësaj historie.

Kush ka pyetje?

Sherefedin Shehu – Për anën formale është e rëndësishme...

Erion Braçe – Kemi pyetje, apo diskutime?

Sherefedin Shehu – Ky është një ligj, i vetmi që na vjen në këtë legjislaturë si ligj i plotë dhe duhet ta shikojmë shumë seriozisht. Është një ligj për të cilin kanë punuar institucione dhe organizma të specializuara ndërkombëtare, kështu që unë them se duhet ta marrim shumë seriozisht dhe ngadalë shqyrtimin e tij. Të bëjmë lexim dhe rilexim të tij, me qëllim që të mos kthehemi pas një apo dy muajsh që të shikojmë se nuk i paskemi bërë mirë punët.

Kam dy pyetje, që janë më shumë edhe shqetësime. Për sa u përket masave që propozon KLSH-ja, sidomos për sa u përket penalizimeve që u bëhen drejtuesve të institucioneve apo të tjerëve, a mendoni se kjo del pak jashtë misionit të auditit?

Ju referuat nenin që institucionet duhet të raportojnë te ju për sa i përket zbatimit të rekomandimeve. A nuk e shikon edhe këtë pak jashtë misionit të auditimit? Ajo që ka munguar deri më sot janë raportet me Kuvendin. Ju jeni ndër mekanizmat e Kuvendit të Shqipërisë. Unë mendoj se raportet tuaja duhet t'i vijnë Kuvendit, i cili nëpërmjet

institucioneve publike duhet të shikojë se ku ndërhyhet. Pra, në këtë këndvështrim, a duhet t'i rrijë ligji strikt misionit të auditit, i cili, siç është e, njohur është gjetja e hapësirave apo boshllëqeve në sistem dhe rekomandimi i mënyrës së mbushjes së këtyre hapësirave dhe marrja me individët apo me rekomandimet e tjera specifike, që janë detyrë e menaxherëve? Pra, ju punoni për një menaxher, për Kuvendin e Shqipërisë. Si e shikoni këtë raport dhe a mendoni se ky ligj e materializon këtë koncept?

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Mima, urdhëroni!

Florjon Mima – Faleminderit, zoti Braçe!

Zoti Leskaj, personalisht këtë projektligj e quaj një vepër arti të shkruar tejet me kujdes dhe në përputhje me të gjitha standardet dhe me terminologjinë bashkëkohore. Sigurisht për këtë keni komplimentet e mia personale.

Kam tri shqetësime, ndoshta mund të hapim edhe diskutime me kolegët. Ju i cekët dy prej tyre. E para ka të bëjë me rekomandime apo urdhërime. Nuk gjykoj se KLSH-ja del jashtë fushëveprimit të saj, në rast se ato që shkruan, pavarësisht nëse do t'i quajmë rekomandime apo urdhërime, janë vendime të formës finale të një auditori që kontrollon hallkat ekzekutive. Pushteti gjyqësor vjen më tej dhe në përputhje me hierarkinë e shkallëve të tij mund të japë vendime, të cilat janë të apelueshme në hallkat superiore. Personalisht mendoj se ato që KLSH-ja do të shkruajë në fund të gjetjeve të saj, duhet të jenë urdhërime të formës së prerë për t'u zbatuar, në mënyrë që të mos mbetet në vullnetin e shefave të ekzekutivit për të lëshuar ose jo qarkore për zbatimin e këtyre gjetjeve.

E dyta ka të bëjë me një fushë, që ju e cekët pak, dhe unë kam një njohuri relativisht modeste, atë të koncesioneve. Kontrolli i procedurës së dhënies ose grantimit të një koncesioni nuk e qetëson publikun, pra që ai koncesion po përdoret në interes të tij. Edhe në këtë fushë dua t'ju trimëroj që ta shtrini më tej fushëveprimin e aktivitetit tuaj duke kontrolluar edhe pjesën e zbatimit dhe të angazhimeve që koncesionari ka marrë në përputhje me investimet, me punësimin, me taksat që do të paguajë etj.

E treta, që është me të vërtetë një shqetësim, pasi më kujtohet edhe historiku i ngjarjes. Kam parasysh konfliktin tuaj me administratën tatimore, që përfundoi në një gjykatë fakti totalisht jashtë fushëveprimit të Gjykatës Kushtetuese, sepse, në fund të

fundit, duhet të kishte qenë ajo që duhet ta kishte bërë interpretimin se ç'nënkuptonte me ato klauzola specifike të dy neneve, një në ligjin tuaj dhe një në ligjin e administratës tatimore. Pra, personalisht kam qenë i idesë se ishte gabim vajtja në gjykatë. Përsëri në projekt nuk gjej asgjë që t'i japë autoritet...

Erion Braçe – Është.

Florion Mima – Nuk është e qartë. Është pothuajse siç ka qenë dhe nesër përsëri do të shkojë në gjykatë.

Erion Braçe – Jo. “I jepet autoritet KLSH-së të shkojë në Gjykatën Kushtetuese për rastin e mosmarrëveshjeve”.

Florion Mima – Nuk e kam për këtë. E kam për të marrë në dorë të dhënat e dosjeve të subjekteve private, sepse kjo ishte baza që u sulmua nga administrata tatimore.

Edhe në këtë punë dua t'ju trimëroj dhe t'ju inkurajoj për të bërë zgjedhjen e duhur në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Zoti Leskaj, meqë pyetje apo kërkesa për sqarime nuk ka, mbase do të kemi më tepër në momentin kur të hyjmë në diskutimin nen për nen.

Fjalën e ka zoti Bode.

Ridvan Bode – Mendoj se është shumë e domosdoshme të përmirësohet ligji, pasi gjatë viteve të fundit ka pasur realisht një progres shumë të madh të standardeve të auditimit qoftë të brendshëm apo të jashtëm në të gjithë botën. Për më tepër, Komisioni European ka nxjerrë direktivat dhe standardet e reja të auditimit, një pjesë e të cilave janë implementuar për auditimin e brendshëm nga ana e qeverisë për ngritjen e njësive dhe të mënyrave të reja të përdorimit të fondeve publike, por auditimi i jashtëm kishte mbetur ende pa reflektuar një pjesë të standardeve dhe kërkesave të reja. Jam i bindur se ndryshimi i këtij ligji shkon në të njëjtën kah për të plotësuar standardet dhe direktivat e reja edhe në auditimin e jashtëm.

Ajo që shqetëson, me një sy që i hodha, është, të themi, një kakofoni konceptesh që përdorim në hartimin e ligjeve. Jemi përsëri përpara një ligji, që nuk mendoj se është standardizuar nga ana e koncepteve. Konceptet kanë të bëjë me praktika dhe me objektivat e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Në këtë drejtim, kam si sugjerim të

parë: të sillen në të njëjtin koncept dhe në të njëjtën përcaktueshmëri konceptet që përdoren për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Po t'i shohësh konceptet, ato jepen me një seri nocionesh, të cilat janë një inflacion dhe nuk përputhen me realitetin. “Auditimi i IT-së”: një herë flitet për efektivitet, një herë flitet për efikasitet. Thuhet “nënkupton vlerësimin e kontrollit, projektimit dhe efektivitetit në sistemin e brendshëm”. “Ky auditim përfshin, por nuk kufizohet vetëm në efikasitetin dhe sigurinë e protokolleve...”. Pastaj kemi konceptin e auditimit të performancës. “Ka të bëjë me auditimin e ekonomikitetit”. Ky koncept nuk është praktik dhe nuk nënkupton asgjë.

Ky është thjesht inflacion fjalësh që futen në objektet e ligjeve dhe në ligje, të cilat nuk prodhojnë ndonjë gjë konkrete. Tri janë konceptet që kanë të bëjnë me auditimin, por nuk janë këto. Mendoj se përkthimet duhet të unifikohen. “Accountability” nuk do të thotë “ekonomicitet”. Tri janë fushat që ka auditimi i jashtëm dhe i brendshëm. E para, ne i themi dhe është shkruar nëpër ligje të tjera, “shpenzimi me llogari”. Kur themi “shpenzimi me llogari”, edhe ky nuk është një koncept, por është përpunuar dhe ka mbetur deri më sot. Tani nxjerrim “ekonomicitet”, për të thënë “shpenzim me llogari”. Çfarë nënkupton kjo? E para, akauntibiliteti nënkupton se sa fondet publike janë shpenzuar në mënyrë të drejtë, në përputhje me ligjin (kjo është çështja që bën më shumë KLSH-ja, sepse me këtë çështje merret më shumë në auditimet e tij), se sa veprimet e kryera janë në përputhje me ligjin dhe se sa këto veprime apo pasqyrime në llogaritë kombëtare janë apo nuk janë me standarde. Këtë bën më shumë dhe këtë ka bërë deri më sot KLSH-ja, pra se sa janë të përputhura me ligjin veprimet në nxjerrjen dhe në përdorimin e fondeve publike. Të zëvendësosh konceptin e përputhshmërisë me ligjin dhe me standardet me fjalën “ekonomicitet”, mendoj se nuk thotë gjë. Pra, cili është objekti i auditimit “se sa janë të përputhura me ligjin”? Ju e keni zëvendësuar me fjalën “ekonomicitet”. Mendoj se kjo nuk shkon.

Së dyti: çfarë ka përfshirë në objekt auditimi brendshëm dhe i jashtëm sot? Ne i themi “efektiviteti i përdorimit të fondeve”. Janë koncepte, të cilat janë standardizuar tashmë në literaturën ndërkombëtare. Ne fjalën “efektivitet” e përdorim edhe në vend të “efikasitetit”. Kur themi “efektive”, tashmë administrata ka filluar të përdorë një sërë treguesish për të matur efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Ç’do të thotë kjo? Se fondet publike që harxhojmë apo që nxirren, plotësojnë qëllimin për të cilin janë

përdorur? Sa nga këto fonde që kemi hedhur ne në spitale, fjala vjen, kanë përmirësuar cilësinë e shërbimit spitalor? Për këtë është një bateri treguesish që është ndërtuar tashmë nga Ministria e Financave, e cila bën matjen dhe në fund i thotë Ministrisë së Shëndetësisë që ka pasur për objektiv... Pra t'i bëjmë të matshëm treguesit e shërbimeve publike në përputhje me fondet që u japim. Kjo ka të bëjë me konceptin e efektivitetit, i cili ka filluar, por do kohë. Domethënë, është cilësi shumë e lartë që për fondin që jepet të marrësh produktin, t'i thuash që me këtë fond do të merreshin këto produkte, i ke marrë, apo jo? Kemi filluar t'i bëjmë. Nuk janë ende detyruese, por administrata dhe Ministria e Financave i bëjnë. Kjo do të kërkojë kohë.

Koncepti i tretë nuk ka të bëjë me efikasitetin ose si e përdorni ju, por është efienca. Një gjë që mbetet si objektiv, por nuk arrihet. Çfarë do të thotë kjo? Që sa impakt kanë në ekonominë reale dhe në atë të çdo qytetari fondet publike që shpenzohen. Kjo është shumë e largët. Është efienca lidhja e përdorimit të fondeve publike apo të nxjerrjes së fondeve publike me impaktin e drejtpërdrejtë në ekonomi.

Mendoj se tri konceptet bazë që kanë të bëjnë me auditimin këtu janë ngatërruar në një formë të tillë, që mendoj se janë shndërruar në një kakofoni konceptesh, të cilat nuk përputhen.

Dua t'ju them se duhet t'i bëjmë gjërat e përputhura dhe të jemi brenda koncepteve bazë që përdoren në standardet ligjore, sepse çdo ligj që vjen me koncepte dhe përkufizime të reja shkakton vetëm anomali më të madhe në konsolidimin e disa praktikave dhe koncepteve, që kanë të bëjnë me fushën e ekonomisë dhe të financave. Këtu e kam fjalën për auditimin. Prandaj, do t'ju kërkoja të bënit edhe një herë një verifikim, në lidhje me konceptet bazë të përdorura në ligjin ku e keni marrë me përkthimet që keni bërë. Përkthimet nuk janë çështje vetëm e përkthyesve, por edhe e ekonomistëve dhe duhet një bashkëpunim më i mirë midis tyre. Ka një njësi Ministria e Financave që është kualifikuar në BE, e cila ka punuar gjatë me konsolidimin e disa koncepteve, në mënyrë që t'i kemi gjërat e përputhura dhe të mos kemi një rishpërndarje kaq të madhe konceptesh thjesht për përkufizime.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Angjeli, keni fjalën.

Anastas Angjeli – Në fakt, këto ditë po lexoja historikun e KLSH-së, që kur është krijuar e deri tani dhe dy gjëra më vajtën në mendje:

Së pari, në këto 20 vjet KLSH-ja është drejtuar nga personalitete, të cilat, edhe për rastësi, edhe për shkaqe politike, kanë qenë kryesisht të PD-së.

Së dyti, ne jemi përballë ndryshimeve të një ligji, i cili ka qenë miratuar në vitin 1997 me dy ndryshime të vogla, rreth 17 vjet më parë, atëherë kur institucioni i KLSH-së ishte në fillimet e tij. Për fat në atë kohë kam qenë pjesë e këtij grupi, si kryetar komisioni, bashkë me SIGMA-n. Tani i kthehemi pas 17 vjetësh.

Ajo që ne duhet të diskutojmë sot është: a jemi, apo jo dakord që të ndryshojë ky ligj? Kjo është çështja më themelore, sepse jemi në diskutimin në parim. Me sa kuptova, për këtë besoj se nuk kemi ndonjë kundërshtim, bashkohemi me idenë që pas 17 vjetësh eksperience pune të KLSH-së; evolimit që ka ndodhur në proceset e zhvillimit të ekonomisë së tregut; harmonizimit të ligjeve tona me ato të vendeve më të zhvilluara të BE-së; problemet që ka nxjerrë edhe globalizimi i ekonomisë dhe bashkëpunimi në kushtet e globalizimit; detyrimet që ne kemi ndaj organizmave ndërkombëtarë për të arritur në unifikimin e standardeve të auditimit, si dhe përvoja që nxori zbatimin e ligjit në vendin tonë janë disa detyrime që na bëjnë të bashkohemi të gjithë me mendimin se ky ligj duhet të ndryshojë dhe është mirë që më në fund erdhi në Komisionin e Ekonomisë për t'u diskutuar dhe për t'u ndryshuar. Pa dyshim që nuk mund të themi se çdo gjë është e përkryer, sepse po të ishte e tillë ky ligj nuk do të kishte ndryshuar. Por fakti që për këtë ligj ka dy vjet që po punohet; ka një angazhim të të njëjtave institucioneve që janë marrë para 17 vjetëve me të, të cilët e kanë ndjekur zbatimin e tij në vendin tonë, po vazhdojnë të merren në nivel europian dhe bashkëpunojnë me institucionin e Kontrollit të Shtetit; fakti që domosdoshmëria e tij vjen edhe për shkaqe të modernizimit të rolit të këtyre institucioneve në vendet e tjera, por edhe të nismave, rregulloreve, dokumenteve dhe akteve që kanë nxjerrë organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, na obligon të bashkohemi me nismën për ta diskutuar dhe, natyrisht, për t'ia përcjellë Kuvendit.

Tani po kaloj në çështjen e sugjerimeve që u bënë këtu: a duhet të nxitohemi?

Unë nuk besoj se këtu po bëhet ndonjë sprint, por jemi përballë një procedure normale të një nisme, sipas Kushtetutës, të një dokumenti ligjor që ka përgatitur institucioni i KLSH-së dhe jemi futur në procedurën normale të diskutimit të tij.

A duhet ta shikojmë me vëmendje? Kjo është përgjegjësia jonë individuale: dikush është i përgjegjshëm dhe i vëmendshëm, dikush ka një shqetësim tjetër. Nuk mund të marrim ne vendimin ta shikojmë me vëmendje. Secili e shikon me vëmendjen dhe me aftësinë që ka.

A ka probleme akti i paraqitur? Pa dyshim. Nuk ka akt që ka ardhur në Komisionin e Ekonomisë, pavarësisht nga nisma, që nuk ka pasur qoftë probleme teknike, qoftë probleme të neneve, qoftë përplasje me ligjet e tjera, qoftë edhe çështje konceptuale apo të terminologjisë së përdorur. Por kjo nuk na ka penguar ndonjëherë që ne me sukses t'i diskutojmë këto ligje dhe të gjejmë zgjidhje.

Kështu që, unë besoj se nëse do të ketë çështje që kanë të bëjnë me çështjen e koncepteve, që edhe zoti Bode e ngriti, dhe me çështjen e përplasjes terminologjike, ne kemi dy mundësi (që mua nuk më duket se janë në të gjitha nenet dhe ka probleme që mund të na krijohen në momentin e miratimit).

Mundësia e parë është që gjatë diskutimit nen për nen, atje ku mendojmë se efienca apo efektiviteti, kush e ka pasur në mendje për t'i përdorur, ne e zëvendësojmë.

Mundësia e dytë është që nga koha e diskutimit sot në parim deri në diskutimin nesër nen për nen ekspertët dhe këshilltarët tanë, së bashku me ekspertët e tjerë, mund të bëjnë një ballafaqim të këtyre terminologjive, që gjatë shqyrtimit nen për nen t'i kalojmë. Pa dyshim që mund të kemi çështje dhe propozime të reja të ndonjë kompetence të tejkalimit apo jo të masës nga ana e KLSH-së, apo të delegimit në organet e drejtësisë të ndonjë kompetence, ne këtu jemi. E rëndësishme është që ne në parim kemi pranuar frymën e një dokumenti të ri dhe të një reforme në KLSH, e cila realizon disa qëllime kryesore:

Së pari, rritjen e pavarësisë qoftë institucionale, qoftë organizative të KLSH-së, që synon harmonizimin e legjislacionit dhe të veprimtarisë së tij me rregullat bashkëkohore që kanë sot format e auditimit dhe institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet e tjera.

Së dyti, i jep mundësi këtij institucioni që të bashkëpunojë më mirë me institucionet e ekzekutivit, por edhe me legjislativin nga i cili varet, për të rritur edhe ne përgjegjshmërinë tonë, çështjet që kanë të bëjnë me problemet e auditimit, sidomos kur

bëhet fjalë për fondet publike, të cilat kanë qenë dhe mbeten një problem shqetësues për të gjithë ekonominë e vendit tonë.

Kështu që, ne sot e përkrahim në parim futjen në diskutimin nën për nen të çështjeve të këtij ligji. Besoj se të gjithë duhet të kontribuojmë që ky ligj, kjo punë kaq e madhe që është bërë, të marrë dorën e fundit të përsosmërisë, edhe nga komisioni, sipas mundësive.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Leskaj, keni fjalën.

Bujar Leskaj – Në fakt, përpara se t’u përgjigjem pyetjeve, do t’ju lutesha të mos keqkuptoheni, të nderuar deputetë, në përgjigjet që do të kthej.

Nuk mund të flitet për shpejtësi në një ligj, kur të paktën që më 26 nëntor të 2012-s ky ligj është depozituar te Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë. Me legjislaturën e re, në shtator të vitit 2013, te Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë. Në korrik të vitit 2012, ne kemi përgatitur edhe një tabelë, që mund t’ju japim, të cilën në rrugë informale ua kam dërguar deputetëve anëtarë të Komisionit të Ekonomisë. Për hir të së vërtetës, zoti Shehu ka pasur bashkëpunim konstruktiv edhe me ne, edhe me specialistët e SIGMA-s dhe të DG/budget.

Në lidhje me masat që propozon KLSH-ja, ne këto i kemi te neni 14 i projektligjit tonë, i cili është një ripunim.

Erion Braçe – Neni 16 i ligjit ekzistues.

Bujar Leskaj - Realisht, për të qenë të sinqertë, DG/budget dhe SIGMA kanë insistuar në riformulimin e nenit 16 ekzistues, pasi ky nen reflekton një karakter të fortë inspektimi. Duke marrë parasysh këto, ne, po të shikoni në termat e përdorur, jemi përpjekur të jemi të kujdesshëm. Ne kemi kaluar nga fjalët “të kërkoj nga subjektet e kontrolluara” tek “të informojë drejtuesit e njësive të audituara”. Pra: “Të kërkojnë nga subjektet e kontrolluara marrjen e masave disiplinore në përputhje me ligjet përkatëse ndaj personave që kanë shkaktuar dëme direkt ose indirekt” tek “Të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo institucionet më të larta për parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve dhe t’u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjit apo akteve nënligjore të kompensohet dhe shpërblehet në mënyrën dhe

rrugët e përcaktuara nga ligji”. Në këtë drejtim unë mendoj se ne jemi treguar shumë korrektë.

“T’u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara të ndërmarrin mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë dhe nisjen e procedurave disiplinore dhe administrative”. Edhe në këtë drejtim ne kemi bërë një ripunim të kujdesshëm të ligjit. Pavarësisht se KLSH-ja duhet të fokusohet në detyrat e veta themelore, kërkesa jonë ndaj subjekteve që ne auditojmë për marrjen e masave, qoftë administrative, qoftë dëmshpërblim dëmi, mendoj se nuk e rëndojnë pozitën e subjekteve që ne auditojnë dhe nuk cenojnë parimet klasike të auditimit.

Është e vërtetë që ne si auditues të jashtëm (ne jemi auditues të jashtëm dhe auditojmë subjektet e interesuara), marrëdhënien e agjentit e kemi me Kuvendin e Shqipërisë. Të paktën në këto dy vjet unë jam përpjekur që edhe kontaktet me ju si Komision Ekonomie t’i kem më të shpeshta, edhe ftesat e mia, pavarësisht përgjigjes nga ju, por edhe konsultimet me ju të jenë më të shpeshta. Ne jemi agjentë të Kuvendit, jo të njësive që auditojmë. Fakti që ne nuk jemi agjentë të njësive që auditojmë, (ne nuk jemi agjentë të qeverisë), na bën që në rekomandimet tona të kemi një dozë më të fortë. E theksoj, jemi treguar gjithmonë të kujdesshëm edhe në përdorimin e fjalëve, kemi përdorur fjalët e duhura. Nuk mendoj se kjo përbën shqetësim.

Pra, përgjigjja ime për pyetjen nëse mendojmë se dalim jashtë parimeve të auditimit, është jo. Në rast se ne do të dilnim jashtë parimeve të auditimit të jashtëm, te kjo pjesë nuk besoj se do të kishim OK-ejn përfundimtar të DG/budget dhe të SIGMA-s.

Jam shumë dakord me ju për raportet tona me Kuvendin, kjo theksohet edhe në progresraport. Pikërisht ky ligj dhe ky konceptim i frymës së auditimeve tona këtij raporti do t’i shërbejë. Jo marrje me individët. Ky është një problem që meriton vëmendjen tuaj. Ne jemi në një stad ku të gjitha institucionet e Shqipërisë, duke filluar nga ju si deputetë të Kuvendit, por edhe ne të tjerët, duhet të kontribuojmë për të respektuar ndjeshmërinë popullore për luftën kundër korrupsionit. Unë nuk di ndonjë formë tjetër, kur konstatojmë që persona të caktuar kanë abuzuar me detyrën ne të mos i padisim në prokurori apo mos t’u propozojmë organeve eprore të tyre largimin nga detyra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fakti që Shqipëria është në këtë stad korrupsioni tregon që njësia përkatëse e inspektimit në Ministrinë e Financave nuk e ka bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Ju lutem, të mos e kthejmë në debat, por të dëgjojmë njëri-tjetrin.

Bujar Leskaj – Unë po përpiqem dhe mendoj se në këto dy vjet ia kam arritur, jo deri në fund, sepse e mira nuk ka fund, që ne të largohemi nga ajo fryma e institucionit të inspektimit. Domethënë, ne kemi një raport vjetor tërësisht të përcaktuar dhe nuk devijojmë nga ai edhe në veprimtarinë, edhe në metodologjinë që kërkojmë. Por kjo nuk do të thotë që ne KLSH-në ta kthejmë në një OJF. Në rast se ju si deputetë të Kuvendit e ktheni në OJF, bujrem. Le ta marrin vesh edhe qytetarët shqiptarë që KLSH-ja është një OJF, por që paguhet nga buxheti i shtetit dhe ne do të vazhdojmë auditimet në atë linjë që ju do të përcaktoni.

Ne jemi të përgjegjshëm dhe po punojmë, duke e konsideruar veten si agjentë të Kuvendit të Shqipërisë.

Në vijim të kësaj dhe të tria rekomandimet apo sugjerimet pozitive që bëri deputeti Mima, unë mendoj që kur të bëhet diskutimi i neneve të veçanta do të japim edhe sqarime. Unë personalisht e falënderoj deputetin! Kur të kalojmë në diskutimin e neneve ju duhet të përcaktoni një stad që se si rekomandimet tona, në veçanti për largimin e drejtuesve të lartë që abuzojnë me detyrën, duhet të zbatohen nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore. Deri në këto momente ka qenë një urdhër i vitit 2006 i Kryeministrit Berisha. Ky urdhër, për të qenë të sigurtë, na ka shërbyer shumë në punën tonë. Kjo është rrjedhojë e faktit që 75% e rekomandimeve tona janë zbatuar edhe për këto largime. Por, më duhet të theksoj këtu, për sa i përket largimit të drejtuesve të lartë se treguesi është shumë i ulët, 50%. Çka tregon që ky urdhër ka nevojë të ripunohet nga Kryeministri aktual. Ndoshta ka nevojë të përcaktohet në një mënyrë detyruese ose edhe këshilluese në ligj. Kjo është një gjë që ka nevojë për diskutim të projektligji i ri që ne kemi paraqitur.

Erion Braçe – Do ta zgjidhim në ligj, zoti Leskaj, nuk mund ta lemë në dorë të urdhërimeve të institucioneve të tjera. Do ta zgjidhim këtu në ligj dhe me afat kohor.

Bujar Leskaj – Në rast se ju e zgjidhni në ligj, kjo do të jetë një dëshmi shumë e fortë, por edhe një obligim shumë i fortë për ne për të vazhduar të punojmë si agjentë të Kuvendit.

Te materialet shtesë do t'ju sjellim edhe përvojën sllovene dhe të institucioneve të tjera për sa i përket auditimit të koncesioneve. Personalisht jam për idenë që ne si KLSH duhet të vazhdojmë të auditojmë edhe zbatimin e koncesioneve, pra t'i auditojmë këto subjekte. Edhe kjo kuptohet është e drejta juaj.

Për ato probleme që ne kemi pasur, për sa i përket dhënies ose mosdhënies së informacionit, unë dua të theksoj këtu që në çdo kohë KLSH-ja është penguar në dhënien e informacionit edhe nga drejtues të lartë. Nuk po flas këtu për ministra, por për drejtorë të njësive të fiskut. Është penguar me qëllim dhe kjo pengesë, mendoj unë, i ka sjellë dëme të konsiderueshme buxhetit të shtetit. Ju jeni deputetë, mund t'i analizoni shumë herë më mirë se mua. Ne kemi qenë prej më shumë se dy vjetësh, ose më saktë kur erdha unë e gjeta prej një viti e gjysmë të bllokuar nga një vendim absurd i Gjykatës së Apelit. Natyrisht, unë nuk komentoj vendimet e gjykatave, kam respekt për to, i kam respektuar deri në fund, por ama edhe institucioni tjetër, në shtator të vitit 2013, kur ne fituam, bëhet fjalë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kur Gjykata e Apelit dha një vendim në favorin tonë, nuk po e zbaton këtë. Kam vënë në dijeni ministrin e Financave.

Për sa i përket diskutimit apo sugjerimeve që bëri zoti Bode, pavarësisht respektit që kam për ju, zoti deputet dhe zoti ish-ministër, më duhet të theksoj këtu që termi i përfolur prej jush “kakofoni kompetencash”, nuk qëndron për këtë projektligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë këtu e kam shënuar që keni thënë “kakofoni konceptesh”, por qoftë kakofoni konceptesh, qoftë kakofoni fjalësh, nuk është e drejtë të përdoret nga ju me një përvojë mbi 10 vjet si ministër Financash për një ligj, kur ju e dini vetë sesa shumë përpjekje e sa shumë mund është derdhur. Natyrisht, në përcaktimet, mund të jetë, për të mos debatuar me ju, edhe ndonjë gabim i vogël, por kjo nuk mund të hedhë poshtë punën. Unë jam dakord që ato përcaktime t'i shikojnë ekspertët tanë. Më duhet t'ju pohoj këtu që ne, për sa u përket përcaktimeve, tre E-të e famshme, që karakterizojnë auditimin e performancës, i kemi marrë nga standardet INTOSTAI. Natyrisht, nuk kishim si t'i merrnim nga standarde të tjera, por për të qenë korrekt me ju, disa prej termave të

përkufizimit janë marrë edhe nga legjislacioni ynë i brendshëm, si, për shembull, nga ligji nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 2 dhe neni 3; ligji i vitit 2010 “Për inspektimin financiar publik”; ligji nr.9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” etj. Po të fillojmë të merremi me fjalë të vogla i bie që në fillim ne kemi një mospërputhje ndërmjet asaj çka flet Kushtetuta, që flet për kontroll, dhe asaj që ne flasim për auditim, apo atij ligji, ligj shumë të mirë, që ju keni përgatitur në vitin 2007, ku flisni për auditimin e brendshëm dhe jo për kontrollin e brendshëm.

Për sa i përket asaj që merret më shumë KLSH-ja, me auditimin financiar etj., ju po flisni për të kaluarën ose për të sotmen, ne bëjmë një ligj që t’i shërbejë të sotmes, por të jetë edhe bazë e fortë për të ardhmen. Unë jo më kot ju citova, nuk i kam qëllim në vetvete për të treguar çfarë lexoj unë apo stafi im, sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAIT, që në 2013-ën institucionet supreme të auditimit ecin paralelisht: auditimi dhe këshillimi dhe kur flasim për këshillim, nuk flasim për një individ, Bujar, që drejton, por për kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit apo për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe pjesë e kësaj filozofie është edhe futja e konceptit të auditimit të performancës që po futet në masë. Në rast se vendet e përparuara kanë 20 vjet, 30 vjet dhe më shumë, ne ndoshta mund të flasim pa fund për auditimin e performancës, këtu në Shqipëri është një përvojë shumë e dobët. Nga një projekt binjakëzimi, që, për hir të së vërtetës, u fitua në kohën që drejtonte zoti Kërçuku dhe u implementua në kohën kur drejtonte zoti Çeku, u zhvilluan deri diku disa koncepte, të cilat, për fat të keq, u lanë në heshtje, u lanë në pasivitet. Unë e kam riaktivizuar, edhe në platformën që kam paraqitur këtu, në nëntor të vitit 2011, me bindje të plotë dhe jam shumë i kënaqur që bindja ime, që pohova këtu te ju, shkon në sinkron me standardet INTOSAI dhe me atë drejtim që kanë institucionet moderne sot, rendjen tonë drejt auditimit të performancës, pa lënë mënjanë natyrisht auditimet e tjera. Edhe në progresraportin e BE-së të vitit 2013, pa dyshim ju keni qenë të vëmendshëm, ka një vlerësim specifik të veçantë për këto auditime performace që ne kemi zhvilluar dhe ne kemi zhvilluar disa auditime performance, të cilat kanë qenë me shumë vlerë, por për fatin tonë, për një defekt të vogël, ndoshta në komunikim, nuk i kemi tejçuar aq sa duhet në komunitet, në publikun e gjerë, jemi mjaftuar vetëm me institucionet qendrore. Mjafton t’ju pohoj këtu, për shembull, që në tetor të vitit 2013, pra kur qeveria e re kishte

një muaj punë, ne si Kontroll i Lartë i Shtetit kemi përgatitur progresraportin për ndarjen territoriale administrative në Republikën e Shqipërisë dhe në nëntor, dhjetor ne e kemi dërguar këtë te ministrat kryesorë, ministrin e Pushtetit Vendor, ministrin e Reformës, ministrin e Brendshëm, ministrin e Financave...

Erion Braçe – Deputetëve të Kuvendit.

Bujar Leskaj – Jo te deputetët e kam dërguar më vonë kur pashë që asnjë nga drejtuesit e lartë nuk e citonte. Megjithatë nuk ishte ky problemi.

Ideja është që ne do t'i fusim këto koncepte dhe do t'i fusim në bazë të standardeve INTOSAI. Mund të shikojmë ndonjë përkthim, por tre E-të janë të famshme. Vërtet administrata ka bërë përpjekje pozitive, në të cilën ju ishit nga drejtuesit më të lartë, për të bërë të matshëm tre E-të, por ama është edhe një institucion i jashtëm që duhet t'i auditojë dhe ne pikërisht këtë po përpiqemi të bëjmë, të auditojmë se si tre E-të reflektohen në administratën shqiptare me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

Për sa i përket termit “ekonomikitet” nuk jam dakord me ju, ky term përdoret. Një nga dy termat e tjerë ndoshta ne këtu kemi bërë gabim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne e përdorim ekonomikitet. Auditimi i performancës nënkupton një auditim sistematik, po citoj, për sigurimin e një vlerësimi të drejtë dhe të pavarur lidhur me ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve, procedurave, funksioneve dhe përdorimit të burimeve të subjektit të audituar në kryerjen e përgjegjësiave të tij. Me efektivitet do të kuptojmë shkallën në të cilën objektivat e programuara janë arritur për secilin aktivitet dhe raportin ndërmjet ndikimit të parashikuar dhe rezultatit të aktivitetit përkatës. Me efikasitet do të kuptojmë maksimizimin e rezultateve të një aktiviteti në lidhje me burimet e përdorura. Me ekonomikitet do të kuptojmë minimizimin e kostove të burimeve për të arritur rezultatet e vlerësuara të një aktiviteti, duke ruajtur cilësinë e duhur të këtyre rezultateve. Qëllimi i këtij lloji auditimi është përmirësimi i metodave të punës. Ky është përkufizim që ne e kemi marrë nga INTOSAI, megjithatë unë jam dakord që specialistët tuaj të Komisionit të Ekonomisë dhe tanët ta rishikojnë ose ndoshta t'i drejtohem ndonjë gjuhëtari. Unë një gjuhëtar të madh njoh profesor Shaban Demiraj, që është nga Vlora, po është shumë i sëmure dhe nuk mund ta...

Ekonomiciteti është punë përkthimi. Ekonomiciteti përdoret si term. Eficienca është tjetër. Ose në mënyrë ekonomike.

Erion Braçe – Zoti Leskaj, a mund ta bëjmë këtë diskutim kur të kalojmë te neni respektiv?

Bujar Leskaj – Dakord, kjo është pjesë përkufizimesh ose ndoshta kjo ndërhyrja e ish-ministrit është si puna e asaj rrotës së piromanit që ne të merremi me këtë dhe të harrojmë ligjin. Megjithatë mund t’jua tregoj historinë më pas.

Tani, ju lutem, të vazhdoj t’u përgjigjem pyetjeve apo komenteve të profesor Anastas Angjelit, të cilin e falënderoj për mbështetjen!

Kishte diçka që, dua apo jo unë, duhet ta pohoj: deputeti Angjeli thotë që Kontrolli i Lartë i Shtetit është drejtuar në këto 20 vjet nga personalitete të PD-së.

Erion Braçe – Nuk ka lidhje me ligjin kjo.

Bujar Leskaj – Ka lidhje me ligjin, se personalitet i Partisë Demokratike ka qenë vetëm zoti Blerim Çela. Ata dy të tjerët jo e jo, por as unë, se po të isha personalitet i PD-së do të isha te ky krahu këtu në 2011-ën. Unë mund ta bëj historikun këtu se, për fat të mirë, ne kemi bërë edhe një minimuze në KLSH, të cilin unë ju ftoj ta shihni, kemi edhe një botim për historikun e KLSH-së, por Partia Demokratike e ka drejtuar Kontrollin e Lartë të Shtetit vetëm me një personalitet, profesor, doktor Blerim Çelën, nga viti 1992 deri në 1997, në të cilin ju ndërpre mandati në mënyrë të padrejtë. Kaq sa për koment.

Erion Braçe - Të ushtrimit krejtësisht politik të detyrës.

Bujar Leskaj – Nuk e kishte ligji atëherë që të ishte i depolitizuar.

Erion Braçe – E kalojmë këtë gjë, se nuk ka lidhje me ligjin?

Bujar Leskaj – Në mbyllje të këtyre përgjigjeve, dëshiroj të theksoj edhe një herë që duhet të përqendrohemi te fakti që ky ligj ka ardhur në kohën e duhur dhe unë mendoj, për fatin e mirë, se është një situatë e mirë për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Unë këtu flas për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, për raportet që kemi ne me Komisionin e Ekonomisë, duke filluar nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe gjithë deputetët e të dy krahëve dhe shpresoj që kjo frymë të reflektohet edhe në Kuvend, por më duhet të pohoj këtu, me sinqeritet, pasi është më e mira kur flitet dhe shihen drejt e në sy të gjithë anëtarët, ata që kanë në dorë miratimin e këtij ligji, që ne si ekip i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me përgatitjen e këtij ligji, e kemi kryer detyrën tonë në funksion të

detyrimeve që shtrun marrëveshja e stabilizim-asociimit dhe specifikisht neni 90 i saj në funksion të atyre detyrave që për katër vjetët e fundit lihen në progresraportet e BE-së.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Bode e ka fjalën.

Ridvan Bode – Jo, nuk kam replikë se nuk mund të kem replikë.

Lidhur me atë që unë thashë, zoti Leskaj, nuk e kisha fjalën se keni bërë ju kakofoni konceptesh, sepse për të njëjtin koncept në ligjet tona ekonomike përdoren fjalë ose terma nga më të ndryshmit apo për të njëjtën fjalë nënkuptohen koncepte nga më të ndryshmet dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me ju, se po të ishte për herë të parë që vjen një ligj dhe jep një koncept për herë të parë, do ta prananim e do të thoshim se jemi dakord dhe nga sot e tutje ky koncept do të quhet kështu. E kam fjalën për ligje të ndryshme, përfshi këtu edhe ligjin e buxhetit, ligje që kanë të bëjnë me ministri të tjera të linjës, ligjet e taksave etj., që për të njëjtën fjalë kanë nënkuptime të ndryshme apo koncepte të ndryshme dhe kur them kakofoni nuk e kam fjalën që e keni shkaktuar ju këtë kakofoni, kjo ekziston për shkak të përkthimeve me nuanca të ndryshme apo të marrjeve nga origjinali sipas gjuhëve të ndryshme. E mira është, ju ndihmuat vetë duke dhënë disa përkufizime konkrete, që në një ligj, kur e shikojmë që kemi të bëjmë me një diversitet jashtëzakonisht të madh të fjalëve dhe të koncepteve dhe të fenomeneve që vijnë pas fjalëve dhe koncepteve, të jepet përkufizimi, sikur e përmendët ju, të jetë pjesë e ligjit.

Erion Braçe – Ju lutem, mos ndërhyuni, të gjitha janë në projektligj. Edhe ato që ju lexuat ishin në projektligj!

Ridvan Bode – Kjo do të krijonte mundësinë për të thënë që ne me “dorë” këtu nënkuptojmë këtë organ të trupit të njeriut, sepse në një vend tjetër mund të thonë tjetër gjë. Kjo ishte ajo që thashë unë.

Kurse për sa i takon auditimit të performancës, ju mos e merrni si një mungesë tuajën. Unë e thashë pak më parë, tani po zhvillohet rrjeti i treguesve dhe nuk mundet Kontrolli i Lartë i Shtetit të përcaktojë rrjet treguesish për të matur performancën e institucioneve. Duhet që institucionet t’i zhvillojnë ato pa të shkoni ju t’i auditoni. Pra kur thashë që jemi në fazën embrionale të auditimit të performancës, nuk thashë se është Kontrolli i Lartë i Shtetit i pazoti për ta bërë këtë, por sepse ne ende jemi në fazën

embrionale të përcaktimit të produkteve dhe të treguesve të lidhur me shpenzimet që i takojnë dikasterit që shpenzon paratë dhe jo ata që auditojnë.

Erion Braçe – Zoti Leskaj e ka fjalën.

Bujar Leskaj – I nderuar zoti deputet, unë ju kuptova shumë mirë. Natyrisht në përgjigjet që ktheva nuk kisha asnjë kompleks që ju atakonit KLSH-në se e di dashamirësinë tuaj.

Erion Braçe – Ishte një reflektim shumë pozitiv, por, në fakt, kur u shprehët për kakofoninë, u shprehët për kakofoninë në disa nene të këtij ligji.

Bujar Leskaj – Në këto momente më dashamirës jeni ju, zoti Braçe.

Dua të theksoj, për sa u përket auditimeve të performancës që mendoj se janë një sfidë për të gjithë ne, për auditimin e brendshëm, për menaxherët në radhë të parë, që të performojnë më mirë...

Erion Braçe – Sa mirë do të ishte të hynte edhe në parlament kjo gjë.

Bujar Leskaj – Janë edhe për ne si institucion auditimi i jashtëm dhe në këtë drejtim ne kemi shumë për të bërë, nuk mendoj që jemi mirë. Unë them se në auditimin e performancës ne po orientohe mi drejt dhe të paktën këto janë edhe vlerësimet e SIGMA-s dhe të DG/budget, specifikisht për këtë fushë, dhe dhe mendojmë se edhe implementimi i strategjisë sonë 2013- 2017 do të na bëjë që në vite ne të flasim më mirë dhe më plotë për auditimin e performancës.

Unë përfitoj nga ky rast, që pas përfundimit të miratimit të këtij projektligji, ju si Komision i Ekonomisë të na ftoni një ditë, ne të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të folur për auditimet e performancës që ne kemi zhvilluar në këto dy vjet dhe për të na dhënë detyrat përkatëse.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit edhe një herë!

Fjalën e ka zoti Shehu!

Sherefedin Shehu – Unë desha të theksoj dy gjëra në parim.

Së pari, shihet që ky ligj do të miratohet, sepse ish-opozita që e ka penguar, tashmë shprehet dakord, kështu që nuk besoj se ka probleme teknike miratimi i ligjit.

Erion Braçe – Ky projektligj nuk ka hyrë asnjëherë në programin e punës së Kuvendit që ta kishte në dorë edhe ish-opozita. Asnjëherë nuk ka qenë në programin e punës së Kuvendit, në kalendar jo e jo.

Sherefedin Shehu – Shkon më përpara në Konferencë të Kryetarëve. Ju nuk e dini si funksionon Kuvendi.

Erion Braçe – Edhe një herë, nuk është paraqitur asnjëherë as në Konferencën e Kryetarëve, as në programin e punës të Kuvendit dhe as në kalendarin e punës së Kuvendit dhe po të them edhe një herë tjetër: po munde, me gjithë kontributin që ke dhënë, referohu në terma konkretë të projektligjit, mos u merr më me politikë. Kaq!

Sherefedin Shehu – Ti nuk të lë të flasësh.

Erion Braçe – Nuk të lë të gënjesh, jo të flasësh. Për të folur, fol sa të duash.

Sherefedin Shehu – Ti personalisht nuk e ke dhënë konsensusin.

Erion Braçe – Nuk ka hyrë asnjëherë në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk ka hyrë në kalendarin e punës për një arsye të madhe, sepse ministrat e qeverisë tënde kanë qenë kundër parimeve që ka projektligji dhe do ta tregoj edhe nenin respektiv ku kanë qenë ministrat kundër, duke përfshirë edhe ministrin tënd të Drejtësisë.

Sherefedin Shehu – Ministrat nuk janë shprehur asnjëherë kundër, përveç opozitës që nuk e ka lejuar të futet në axhendën e Parlamentit.

Erion Braçe – Opozita nuk ka pasur asnjëherë ministra.

Sherefedin Shehu – Bujari e ka të sqaruar, se më 24 prill të 2012 jua ka dërguar të gjithëve.

Erion Braçe - Kërkoja përgjegjësinë ish-kryetares së Kuvendit.

Sherefedin Shehu – E rëndësishme është që ju është mbushur mendja juve, këtë doja të thosha unë.

Erion Braçe – E rëndësishme është që ne kemi 85 vota. Ti po deshe votoje, po deshe mos e voto.

Sherefedin Shehu – Natyrisht që unë do ta votoj, sepse ai është një ligj i përgatitur me një asistencë të kualifikuar.

Erion Braçe – Tani je në opozitë.

Sherefedin Shehu – Unë nuk veproj se jam në opozitë, nuk dal jashtë vetes.

Erion Braçe – Për fat të keq, ashtu ke bërë.

Sherefedin Shehu – Unë standardin profesional e ruaj si në pozitë edhe në opozitë, aq më tepër për ligje të tilla.

Erion Braçe – E kam parë brenda një muaji, nga prilli në maj.

Sherefedin Shehu – Mbylle gojën se nuk të mbyllet goja, kujton se je ende në opozitë!

Erion Braçe – Edhe një herë tjetër, rregullo etikën se ka edhe të folur ndryshe pastaj! Je i vetmi deputet këtu që merr kurajën të fyesh këdo dhe i jep vetes attribute që nuk të lë njeri t'i kesh!

Sherefedin Shehu – Ti më ndërbyn mua.

Erion Braçe – Po deshe fol, po deshe dil përjashta!

Sherefedin Shehu – Nuk më nxjerr ti përjashta, do të flas se kam të drejtën time.

Erion Braçe – Unë mbyll mbledhjen, e ti vazhdo e fol me veten tënde.

Sherefedin Shehu – Ti nuk më lë të flas.

Erion Braçe – Mbyllet mbledhja. Nesër kalojmë në diskutimin nen për nen të projektligjin.

MBYLLET MBLEDHJA